



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

(Projekt)

V E N D I M

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_ \_\_ 2017

P Ë R

**MIRATIMIN E PLANIT TË ZHVILLIMIT TË SEKTORIT TË GAZIT  
NATYROR NË SHQIPËRI (MASTER PLANIT TË GAZIT NATYROR PËR  
SHQIPËRINË) DHE IDENTIFIKIMIN E PROJEKTEVE PRIORITARE NË  
FUSHËN E GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, si dhe të pikave 1, 2 dhe 4 të nenit 5 të ligjit nr. 102/2015, datë 23.09.2015, “Për sektorin e gazit natyror”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e Planit të Zhvillimit të Sektorit të Gazit Natyror në Shqipëri (Master Planit të Gazit Natyror për Shqipërinë) dhe Identifikimin e Projekteve Prioritare në Fushën e Gazit Natyror, sipas tekstit të dokumenteve përbërës të përgatitura nga Konsulenti COWI-IPF, në kuadër të projektit “Master Plani i Gazit Natyror për Shqipërinë dhe Identifikimi i Projekteve Prioritare në Fushën e Gazit Natyror”, të financuar nga WBIF (Kuadri i Investimeve të Ballkanit Perëndimor), të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi.
  - a. Master Plani i Infrastrukturës së Gazit për Shqipërinë, për të cilin është lëshuar Deklarata Mjedisore nga Ministria e Mjedisit nr. \_\_\_\_ Prot., datë \_\_\_\_ . 2017, mbështetur në Studimin për Vlerësimin Strategjik Mjedisor për Master Planin e Gazit Natyror për Shqipërinë dhe Identifikimin e Projekteve Prioritare në fushën e gazit natyror;
  - b. Shqyrtimi Institucional dhe Raporti i Vlerësimit Organizativ dhe Institucional;

- c. Vlerësimi i kërkesës dhe burimeve të furnizimit me gaz natyror;
  - d. Studimi për tarifat
2. Ministria e Energjisë dhe Industrisë, brenda muajit qershor 2017, të përgatisë dhe të paraqesë për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Kombëtar të Territorit materialin për Identifikimin e Projekteve Prioritare në Fushën e Gazit Natyror në Shqipëri.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, si dhe ministritë dhe institucionet përgjegjëse të përmendura në Planin e Zhvillimit të Sektorit të Gazit Natyror në Shqipëri (Master Planin e Gazit Natyror për Shqipërinë).

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**

MINISTRI I ENERGISË DHE INDUSTRIË

DAMIAN GJIKNURI